

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-1305/2

31.05.2023

Kërçovë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 21-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 31.05.2023 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10.00.

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Fortesa Sejdini, Kamer Klosi, Drenuse Dalipi, Valbona Adili Emini, Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, , Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Argjent Asani, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Migjen Zendeli, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari dhe Sibel Tufkegi.

Në seancë morrën pjesë edhe përfaqësues të administratës komunale të Komunës së Kërçovës: Mara Mishkoska, Bekim Mustafaj, Aneta Nasteska- Sekretare e Komunës së Kërçovës, Drejtorët e: SHF „Vlladimir Polezhinoski,,-Kërçovë SHF „Regjë Rushit Zajazi,„ Zajaz, SHF „Naim Frashëri,,- f.Jagoll Dolenci.

Kryesuesi e lexoi propozim rendin e ditës si vijon.

Propozim rendi i ditës:

1 Miratimi i Raportit kuartal për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për periudhën raportuese (komulative) për kuartalin prej 01.01.2023 deri te 31.03.2023.

2. Propozim Vendim për marrjen e borxhit nga SHMK "Drita" Kërçovë.

3. Propozim Plan për punësim për vitin 2024 të:

-SHMK "Drita"

-SHF "Kuzman Josifoski Pitu"

-SHF "Naim Frashëri"

-SHF Dr. "Vlladimir Polezhinoski"

-SHF "Hristo Uzunov"

-SHF "Rexhë Rushit Zajazi"

- 4.Kërkesë për mendim pozitiv për realizim të ekskurzionit të SHF”Rexhë Rushit Zajazi”.
- 5.Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet dokumentacion urbanistik për fsh.Reçan Çellopekut-Kërçovë për shkak të përfshirjes së objektit pa leje.
- 6.Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim në Planin Urbanistik për fsh.TrapçinDoll sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-779/3 të dt.04.07.2002, për PK.nr.1098/6 KK TrapçinDoll jasht.RN në Komunën e Kërçovës.
7. Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim në Planin Urbanistik për fsh.TrapçinDoll sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-779/3 të dt.04.07.2002, për PK.nr.1098/2 KK TrapçinDoll jasht.RN në Komunën e Kërçovës.
- 8.Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve nxënësve të regjistruar në vitin e parë në SHMK”Drita dhe SHMK”Mirko Mileski” Kërçovë.
- 9.Raport për mënjanimin e objekteve të përkohëshme.
- 10.Raport nga NP”Komunalec” për mirmbajtjen e varrezave të qytetit.
11. Të ndryshme:Shqyrtimi i kërkesave.

Para miratimit të rendit të ditës, fjalën e morri:

Valdet Selimi – Propozoi që në pikën e dytë të rendit të ditës të shtohet dhe marrja e borxhit të SHF "Sande Shterjoski", dhe në pikën e tretë të tërhiqet SHMK "Drita", sepse miratimin për shkollat e mesme e jep Kryetari i Komunës, jo Këshilli dhe nuk është në kompetencë të Këshillit.

Valentina Lazarevska- Informon se është bërë praktikë që të mos respektohet Rregullorja e punës së këshillit, sepse atyre nuk u dorëzohet i gjithë materiali për seancat. Ajo theksoi se për pikën e tretë nuk i është dorëzuar material për SHF „Kuzman Josifoski Pitu„ dhe SHF „Hristo Uzunov„, ndërsa në pikën e katërt nuk është dorëzuar plani për ekskursion. Ajo beson se mendimi është dashur të dorëzohet 30 ditë para ekskursionit dhe se është vonuar dhe gjithashtu nuk kanë pasur materiale për pikën për “Komunalecin”.

Valdet Selimi- Për SHF „Kuzman Josifoski Pitu „dhe SHF „Hristo Uzunov„, materialet janë dorëzuar vetëm me shkrim dhe jo në rrugë elektronike, prandaj nuk ju janë dorëzuar. Kërkesa për mendim pozitiv mendoj se u është dorëzuar dhe për “Komunalecin” fola me këshilltarin Mihailo dhe u kuptuam.

Valentina Lazarevska- Informon se drejtoresha e shkollës e ka njoftuar se materialet për SHF „Kuzman Josifoski Pitu,, janë dorëzuar edhe në mënyrë elektronike.

Valdet Selimi- Informatiçarët më kanë njoftuar se nuk janë dorëzuar.

Abdulla Sejdi - Informon se pika e tretë të miratohet pa SHF „Kuzman Josifoski Pitu,, dhe SHF „Hristo Uzunov, për të cilën nuk janë dorëzuar materiale dhe pika e katërt të tërhiqet nga rendi i ditës. Informon se sipas informacioneve të prindërve, ka qenë një ekskursion i cili tashmë është zhvilluar dhe kërkesa është dorëzuar më 10.04.2023 ndërsa pika është dashur të diskutohet në seancën e mbajtur më 28.04.2023, dhe jo tani, prandaj propozon të tërhiqet nga rendi i ditës.

Agim Sadiku - Ai theksoi se nuk ka nevojë që të përsëriten, nëse nuk ka materiale nuk do të diskutohej për këtë pikë dhe të tërhiqet pika e katërt nga rendi i ditës dhe nga pika e tretë të tërhiqen shkollat për të cilat nuk ka materiale.

Laze Jaqimoski - Ai informoi se në lidhje me pikën e dhjetë nuk ka pasur materiale, dhe ka kërkuar që në seancë të marrë pjesë edhe drejtori i NK “Komunalec” dhe të diskutohet për të. Po ashtu, për pikën e nëntë, ai ka kërkuar që në seancë të jetë prezent edhe inspektorja, pasi në raportin me shkrim që kanë marrë, inspektorja ka politizuar dhe nuk kanë marrë përgjigje konkrete dhe ka kërkuar që ajo edhe një herë të sqarohet.

Valdet Selimi- Bën me dije se për pikën e dhjetë të propozuar nga këshilltari Mihailo nuk ka ardhur asnjë kërkesë me shkrim ndërsa Mihailo thotë se ka dorëzuar. Unë dhe Mihailo ramë dakord që kjo pikë të jetë në rendin e ditës në seancën e ardhshme. Sa i përket pikës së nëntë, ai bën me dije se në seancë do të marrë pjesë edhe inspektorja.

Laze Jaqimoski - Ai pyeti se duhet nëse pika e dhjetë duhet të tërhiqet nga rendi i ditës.

Mihajlo Daniloski- Informon se ka dorëzuar material në komunë dhe duhet të shihet pse nuk ka aritur, ka kërkuar që në takim të marrë pjesë edhe drejtori i NK,,Komunalec,.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim procesverbalin e seancës së 20-të të Këshillit të mbajtur më 28.04.2023 dhe u miratua me 23 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit e vendosi propozimin rendin e ditës të propozuar për miratim me propozimin që në pikën e dytë të shtohet dhe marrja e borxhit të SHF,,Sande Shterjoski,, në pikën e tretë të mbetet SHF,,Naim Frasheri,, - SHF,,Vladimir Polezhinoski0,, dhe SHF,, Rexhë Rushit Zajazi,, ndërsa të tjerat të fshihen dhe të terhiqet nga rendi i ditës pika e katërt, si dhe pikën e dhjetë për faktin se për të nuk ka materiale dhe është miratuar unanimisht me 23 vota PËR.

1. PIKA E PARË: Miratimi i Raportit kuartal për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për periudhën raportuese (komulative) për kuartalin prej 01.01.2023 deri te 31.03.2023.

Raportin nga Komisioni për financa, buxhet dhe mbikëqyrje të punëve materiale dhe financiare e lexoi kryetari i komisionit Tefik Lutfiu dhe kërkoi nga këshilltarët që t'i miratojnë pikat që janë shqyrtuar nga komisioni.

Mara Mishkoska - Informon se raporti tremujor K1 është rishikim i të hyrave dhe shpenzimeve të tremujorit të parë dhe se në buxhetin bazë të hyrat janë 15%, kurse shpenzimet janë 13%. Ajo theksoi se në K2 janë paraqitur obligimet e papaguara të cilat janë paraqitur në llogaritë e shpenzimeve dhe i ka shpjeguar ato në detaje.

Agim Sadiku- Informon se ajo që është shfaqur është realizuar dhe nuk mund të ndryshohet. Ai ka theksuar se raportet duhet të bëhen me shkrim, të cilën e ka kërkuar edhe nga një komision që të bëhet krahasimi në periudha të caktuara në vite të ndryshme dhe të shihet nëse ka progres apo jo në komunë. Shifrat nuk mund të kuptoheshin nga ato që nuk janë ekonomistë.

Mara Mishkoska- Ajo bën me dije se dikur edhe ka përgatitur raporte krahasuese, por i kanë thënë se nuk është e nevojshme dhe tani nëse ka nevojë mund t'i përgatisë sërish në detaje.

Agim Sadiku- Informon se e dinte që një gjë e tillë ekzistonte, prandaj edhe e kishte kërkuar.

Mara Mishkoska - Ajo njofton se nuk ka marrë pjesë në seancën e komisionit dhe nuk i është komunikuar, por do ta përgatisë në të ardhmen.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Miratimi i Raportit kuartal për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për periudhën raportuese (komulative) për kuartalin

prej 01.01.2023 deri te 31.03.2023 dhe i njejt i miratua me 13 vota PËR, KUNDËR. (asnjë) dhe 10 vota PËRMBAJTUR .

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për marrjen e borxhit nga SHMK”Drita” Kërçovë.

Sekretarja e Komunës – Informon se bëhet fjalë për marrjen e borxhit të shkollës, pasi janë me llogari të bllokuar dhe nuk mund të punojnë.

Mara Mishkoska – Informon se bëhet fjalë për borxh të SHF,,Drita, 100 mijë denarë dhe SHF,, Sande Shterjoski, 71 mijë denarë.

Agim Sadiku- Informon se faturat me atë borxh duhet të paguhen, në mënyrë që procesi arsimor në shkollë të vazhdojë.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendimin për marrjen e borxhit nga SHMK”Drita” Kërçovë dhe marrjen e borxhit të ShF „Sande Shterjoski,, dhe e njejt i miratua me 23 vota PËR, KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë) .

3. PIKA E TRETË: Propozim Plan për punësim për vitin 2024 të:

-SHF”Naim Frashëri”

-SHF Dr.”Vlladimir Polezhinoski”

-SHF”Rexhë Rushit Zajazi”

Drejtori i SHF „Naim Frashëri,,-f. Jagoll Dolenci – Informoi se plani u është dorëzuar në mënyrë elektronike dhe nëse dikush ka ndonjë pyetje ai do të përgjigjej.

Laze Jakimoski - Ai informoi se e ka shqyrtuar planin dhe se ka parë se ka dy pensionime dhe një punësim, ka pyetur se a është punësimi për ta.

Drejtori i SHF „Naim Frashëri,,-f. Jagoll Dolenci – Informoi se ky punësim është për shërbimet teknike dhe administrative, jo për shërbimin pedagogjik dhe për mësuesit.

Drejtori i SHF "Vladimir Polezhinoski" - Kërçovë - informon se ka nevojë për 3 vende pune: 2 higjenistë dhe 1 roje.

Abdulla Sejdini- Ai pyeti nëse këto janë punësime të reja apo ka pensionime.

Drejtori i SHF "Vladimir Polezhinoski" - Kërçovë - Informon se shkolla kishte nevojë për ato vende pune dhe kishte vite që i kërkonte, por nuk ishin miratuar.

Valentina Lazarevska - Ajo pyeti se sa është rritur nevoja për një roje shtesë, sepse shkolla ka video mbikëqyrje dhe 1 roje.

Drejtori i SHF "Vladimir Polezhinoski" - Kërçovë – Informon se kërkon një punësim për rojtar nate.

Drejtori i SHF "Rexhë Rushit Zajazi" - Zajas – Informoi se plani iu është dorëzuar në mënyrë elektronike dhe nëse dikush kishte pyetje do t'i përgjigjej.

Ramazan Zulbeari – Ai pyeti nëse 2 punësimet e planifikuara janë për mësues.

Drejtori i SHF "Rexhë Rushit Zajazi" – Zajas- Informoi se bëhet fjalë për punësimin e dy mësuesve të rinj, pasi ka të pensionuar.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Plan për punësim për vitin 2024 të:-SHF”Naim Frashëri” -SHF Dr.”Vladimir Polezhinoski” -SHF”Rexhë Rushit Zajazi” dhe i njëjti u miratua me 23 vota PËR.

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash.

Pas pushimit, kryetari i këshillit njoftoi se:

5. PIKA E PESTË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillen dokumentacion urbanistik për fsh.Reçan Çellopekut-Kërçovë për shkak të përfshirjes së objektit pa leje.

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillen ndryshim në Planin Urbanistik për fsh.TrapçinDoll sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-779/3 të dt.04.07.2002, për PK.nr.1098/6 KK TrapçinDoll jasht.RN në Komunën e Kërçovës.

7. PIKA E SHTATË: Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillen ndryshim në Planin Urbanistik për fsh.TrapçinDoll sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-779/3 të dt.04.07.2002, për PK.nr.1098/2 KK TrapçinDoll jasht.RN në Komunën e Kërçovës, -këto janë pika nga Sektori i Urbanizmit dhe do t'i shqyrtojnë në paket, ai theksoi se Komisioni për Urbanizëm nuk është mbajtur për shkak të

mungesës së kuorumit dhe ka kërkuar që në të ardhmen kryetari i komisionit të njoftohet me kohë, nëse dikush mungon, në mënyrë që të dijë nëse e mban apo jo komisionin.

Bekim Mustafaj – Informoi se të gjitha pikat kanë të bëjnë me objekt banimi të vendosura në tokë private dhe ka dhënë një shpjegim të detajuar për secilën pikë.

Më pas, kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet dokumentacion urbanistik për fsh.Reçan Çellopekut-Kërçovë për shkak të përfshirjes së objektit pa leje dhe është miratuar me 17 vota PËR. (asnjë) KUNDËR dhe 6 vota PËRMBAJTUR.

Më pas, kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim në Planin Urbanistik për fsh.TrapçinDoll sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-779/3 të dt.04.07.2002, për PK.nr.1098/6 KK TrapçinDoll jasht.RN në Komunën e Kërçovës dhe është miratuar me 16 vota PËR. (asnjë) KUNDËR dhe 7 vota PËRMBAJTUR.

Më pas, kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim me të cilin përcaktohet se do të sillet ndryshim në Planin Urbanistik për fsh.TrapçinDoll sjellur me Vendim të Këshillit nr.07-779/3 të dt.04.07.2002, për PK.nr.1098/2 KK TrapçinDoll jasht.RN në Komunën e Kërçovës dhe është miratuar me 15 vota PËR. (asnjë) KUNDËR dhe 8 vota PËRMBAJTUR.

8. PIKA E TETË: Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve nxënësve të regjistruar në vitin e parë në SHMK”Drita dhe SHMK”Mirko Mileski” Kërçovë.

Mihajlo Daniloski - Si propozues i pikës, informon se për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve në shkollat e mesme, secilit nxënës të porsa regjistruar, propozon që t'i jepen nga 5.000 denarë për të vazhduar mësimet në qytet.

Kryetari i këshillit – Bën me dije se arsimi i mesëm është i detyrueshëm dhe se nuk ka të parashikuara mjete në buxhet për t'iu ofruar nxënësve. Komuna ofron bursa për studentët. Ai ka theksuar se është konsultuar me Sektorin e Financave dhe se nuk është e mundur në bazë të buxhetit të komunës.

Agim Sadiku - Propozoi që të formohet një komision i cili do ta shqyrtojë dhe në këtë krizë do të ishte mirë që të ndihmoheshin nxënësit që janë në gjendje të keqe ekonomike dhe shuma mund të ishte më e vogël.

Valbona Adili-Informon se nëse mund të ndihmohet nga komnuna për ekskursionë, për nxënës ekselentë etj.

Laze Jakimoski - Ai informon se propozime të tilla kanë pasur edhe për arsimin fillor. Do të ketë efektin të përzgjedhjes p.sh. të çështjeve sociale, të formohet një komision dhe ta shqyrtojë atë. Ai theksoi se për dy vite nuk ka dëgjuar asgjë që të ndihmohet. Me ribalancimin e buxhetit do të mund të bëhej kjo dhe me këtë do të ndihmoheshin edhe familjet.

Kryetari e këshillit - Informon se sipas programit për raste sociale janë ndarë mjete të tilla dhe se komuna ka ndihmuar sipas kornizës buxhetore.

Ivanço Bozhinoski - Ai informon se njerëzit nuk duhet të manipulohen dhe se kanë dashur të financojnë asfaltimin e rrugëve lokale, dhe t'u japin mjete nxënësve të klasës së parë etj., të gjitha këto nuk mund të përballohen nga buxheti.

Laze Jakimoski - Ai informon se nuk bëhej fjalë për 50 kilometra rrugë, bëhej fjalë për 10 euro për nxënësit e klasës së parë. Ai pyeti se prej nga janë siguruar 14 milionë denarë për parqet, për kompensimin e njerëzve të kafshuar nga qentë endacak, ku janë paratë nga kultura që kanë gënjyer për 2 vite.

Mihajlo Daniloski - Informon se qëllimi i Vendimit është arritur, nuk ka mundur të asfaltohen 50 km. rrugë, por mund të asfaltoheshin 3-5 km, e ka dëgjuar zërin e këshilltarëve.

Kryetari i këshillit e vendosi për miratim Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve nxënësve të regjistruar në vitin e parë në SHMK”Drita dhe SHMK”Mirko Mileski” Kërçovë dhe nuk u miratua me 10 vota PËR. 12 vota KUNDËR. PËRMBAJTUR (asnjë).

9. PIKA E NËNTË: Raport për mënjanimin e objekteve të përkohëshme.

Aleksandra Siljanoska - Informon se raportin e ka dorëzuar me shkrim dhe nëse duan të pyesin diçka do t'u përgjigjet.

Laze Jakimoski - Informon se në letër nuk kanë parë përgjigje për pyetjen dhe nuk ka ditur nëse ajo ka qenë në dijeni se kanë paraqitur ide, por nuk janë pranuar. Ai theksoi se sipas ligjit ajo ishte e obliguar që të bëjë raporte tremujore që duhet të jenë në web faqen e komunës. Ai pyeti nëse ka një Vendim për heqjen e objekteve të përkohshme dhe afatet për largimin e tyre dhe pse kjo nuk është bërë deri më tani.

Aleksandra Siljanoska – Informon se është dashur të nenvizojë konkretisht se çfarë duhet të përgjigjet dhe se i ka njoftuar para një viti, se ka pasur një Vendim për zbatimin e heqjes së objekteve të përkohshme.

Laze Jakimoski - Ai ka pyetur se ku janë hequr objektet dhe çfarë është bërë.

Aleksandra Siljanoska - Informon se është rregulluar rruga Mehmed Mehmedi, tash duhet të rregullohet edhe rruga Boris Kidriç.

Laze Jakimoski - Pyeti kush vendos për heqjen e objekteve të përkohshme..

Aleksandra Siljanoska-Informon se për këtë ka vendosur Sektori i Urbanizmit dhe nëse vendoset të bëhet diçka, është kërkuar që të merret Vendim për rrënim dhe është realizuar. Ajo thekson se raportet tremujore i dorëzon në Inspektoratin Ndërtimor Shtetëror.

Laze Jakimoski – Ai pyeti nëse ka një afat deri në të cilin objektet ndërtimore duhet të hiqen.

Aleksandra Siljanoska - Informon se për këtë ka vendosur kryetari i komunës.

Laze Jakimoski- Informon se dëshiron të raportoje publikisht se janë ndërtuar 6-7 objekte në tokë shtetërore në Reshtan për KK Oslome në PK 1541/1, që ka qenë uzurpim klasik.

Ivanço Bozhinoski – Informon se për këtë mund të njoftohet drejtpërdrejt në Prokurorinë Publike të Shtetit.

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Të ndryshme - Shqyrtimi i kërkesave

Kërkesat e pranuar në Këshill u lexuan nga Kryetari i Këshillit.

1. Kërkesa nga BL Tuhin për ndihmë financiare prej 300.000,00 denarë për blerjen e klorit dhe kuarcit, të cilat janë të nevojshme për mirëmbajtjen e ujësjellësit të fshatit

Tuin, i cili është nga burimet e veta dhe nuk është i përfshirë në rrjetin e ujësjellësit të komuna e Kërçovës.

Kryetari i këshillit vendosi që kërkesën t'ia dorëzojë Sektorit përkatës.

2. Kërkesë nga Shezo Ramadani për hapjen e rrugës në një vend që është pronë shtetërore

Këshilli vendosi që Kërkesa të dorëzohet në Sektorin e Veprimtarive Komunale.

3. Kërkesë nga Ilija Shterjoski nga Kërçova, të cilit i është hequr 21 m² nga parcela kadastrale dhe është transferuar në një parcelë tjetër kadastrale.

Ivanço Bozhinoski - Informon se me ligjin e ri pala mund të kërkojë nga drejtoria rajonale për çështje pronësore dhe juridike që t'ia kthejë pjesën me aktvendim për privatizim.

Këshilli vendosi t'i përgjigjet kërkuarit me shkrim.

4. Kërkesë nga banorët e fshatit. Leshnicë për riasfaltim rruge 300 m².

Këshilli vendosi që kërkesën t'ia dorëzojë Sektorit kompetent

5. Kërkesë nga Manifestimi kulturor tradicional ndërkombëtar “Sredbi pod dab” 2023- Shkup për ndihmë financiare prej 376.416,00 denarë, të cilat janë të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për mbajtjen e manifestimit.

Këshilli vendosi që kërkesën t'ia dorëzojë Sektorit përkatës kompetent

Laze Jakimoski - Informon se më dt. 11.04.2023 kanë pranuar kërkesë nga BL Pateec dhe Koziçino për ndërtimin e rrugës në gjatësi prej 2.5 km. Bordi nismëtar kishte arritur marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes për sanimin e punimeve tokësore deri në fazën e asfaltimit. Ai kërkoi ndihmën e gypave të betonit sipas specifikimeve që do të dorëzohen si shtesë, të cilat nevojiten për kanalizim dhe mbartjen e ujit.

Këshilli vendosi që kërkesën t'ia dorëzojë sektorit kompetent.

Në fund të seancës, këshilltari Laze Jakimoski i drejtoi disa pyetje sekretarit të Komunës, për të cilat ende nuk kishin marrë përgjigje dhe për të cilat ajo do t'i përgjigjet me shkrim.

Meqenëse askush tjetër nuk doli të flasë, dhe kështu u shter rend i ditës për këtë seancë, Kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës e mbylli seancën e Këshillit në ora 12:30.

Procesverbalist

-Lençe Srbinoska

-Elisaveta Mileska

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Skender Xhabiri d.v.